



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

Referuar kërkesës për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit më datë 29.05.2026 nga Z. Tonin Prea bëjmë me dije si vijon:

Çështja është regjistruar në Platformën e Bashkëqeverisjes me nr. 914423, datë 29.04.2026, nga z. Tonin Prea, me objekt kërkesën për informacion lidhur me dosjen e depozituar pranë DV ASHK Shkodër - Pukë si dhe pajisjen me kopje të dokumentacionit përkatës.

Pas verifikimit paraprak të ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, bazuar në pikën 1 të nenit 40 të ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”, në datën 29.04.2026 është kryer delegimi i rastit pranë ASHK-së, Drejtoria e Përgjithshme. Në të njëjtën datë, kjo e fundit ka informuar se ankesa e sipërcituar është deleguar për kompetencë pranë DV ASHK Shkodër - Pukë.

Pas marrjes së përgjigjes nga ASHK Drejtoria e Përgjithshme, në datën 29.04.2026 është kryer delegimi për trajtimin e ankesës pranë DV ASHK Shkodër - Pukë, me kërkesë për kthim përgjigje brenda datës 06.05.2026.

Më datë 13.05.2026 (datë e përfundimit të afatit 10-ditor për trajtimin e ankesës), ju jeni informuar për të qëndruar në pritje të përgjigjes përfundimtare. Në të njëjtën datë, është dërguar edhe rikujtesë pranë DV ASHK Shkodër - Pukë për trajtimin e ankesës tuaj, pasi ishin tejkaluar afatet ligjore të trajtimit sipas ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”. Pas kësaj rikujtese të bërë nëpërmjet platformës, nuk rezulton të ketë pasur reagim nga institucioni lidhur me trajtimin e ankesës.

Më datë 28.05.2026, jeni riinformuar për të qëndruar në pritje të përgjigjes përfundimtare të institucionit. Gjithashtu, në të njëjtën datë është dërguar një rikujtesë e dytë pranë DV ASHK Shkodër - Pukë për trajtimin e ankesës, pasi afatet ligjore të trajtimit, sipas ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”, vijonin të ishin të tejkaluara.

Rasti është verifikuar dhe trajtuar në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së dhe DV ASHK Shkodër - Pukë, ç’ka ka sjellë një kohë më të gjatë trajtimi të çështjes.

Në përfundim, bëjmë me dije se ditën e sotme, datë 03.06.2026, rasti juaj ka marrë përgjigje nëpërmjet platformës së Bashkëqeverisjes, duke iu vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj në çështjen nr. 914423 të dokumentacionit të skanuar të dosjes së legalizimit sipas VKM-së 827 në posedimin Tuaj.